

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 27 mars 2012

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 27 mars 2012

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR RISHIKIMIN E MASËS
ZHDËMTUESE URDHËRUAR SIPAS RREGULLËS 68BIS ME MENDIMIN
PJESËRISHT MOSPAJTUES TË GJYKATËSIT HALL**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen M. Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma” dhe “Tribunali”) ka marrë “Mocion i Prokurorit për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis” (“Mocioni”) paraqitur publikisht më 26 tetor 2011. Prokurori kërkon shfuqizimin e vërejtjes së dhënë kryeavokatit të Prokurorisë në rigjykimin *Haradinaj dhe të tjerët*.

1. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 12 shtator 2011, Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj paraqitën “Mocion i përbashkët i Mbrojtjes për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68bis” (“Mocioni i Mbrojtjes sipas Rregullës 68”).¹ Më 20 shtator 2011, Prokuroria paraqiti Përgjigjen e saj ndaj Mocionit të Mbrojtjes sipas Rregullës 68, kurse më 23 shtator 2011 Mbrojtja paraqiti kundërpërgjigjen e përbashkët.²

2. Më 12 tetor 2011, Dhoma nxori “Vendim mbi Mocionin e përbashkët të Mbrojtjes për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68bis”, ku konkludoi se Prokuroria kishte shkelur Rregullën 68.³ Ndër të tjera, Dhoma, (i) i dha vërejtje z. Paul Rogers, kryeavokat i Prokurorisë në rigjykimin *Haradinaj dhe të tjerët*; (ii) urdhëroi Prokurorinë që t’i jepte Mbrojtjes të gjitha materialet

¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68bis, me shtojcën konfidenciale A dhe shtesat konfidenciale 1-12, 12 shtator 2011.

² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68bis, me shtojcat konfidenciale A-D, 20 shtator 2011 (Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Mbrojtjes të Rregullës 68); Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68bis, 23 shtator 2011 (“Kundërpërgjigje e Mbrojtjes e Rregullës 68”).

³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68bis, 12 tetor 2011 (“Vendimi i Apeluar”), para. 71.

e Rregullës 68 në lidhje me Dëshmitarin 75 dhe të gjithë dëshmitarët e tjerë të Prokurorisë dhe të paraqiste një raport të hollësishëm në lidhje me kërkimet e materialeve të tilla prej Prokurorisë; dhe (iii) udhëzoi Zyrën e Prokurorisë që të merrte masa për të garantuar që të gjithë punonjësit e përfshirë në këtë çështje të vireshin plotësisht në dijeni për vendimin e Dhomës dhe të detyrimeve sipas Rregullës 68.⁴

3. Më 26 tetor 2011, Prokurori paraqiti Mocionin aktual. Më 27 tetor 2011, Brahimaj paraqiti publikisht “Përgjigje e Lahi Brahimajt ndaj Mocionit për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis”.⁵ Më 8 nëntor 2011, Balaj paraqiti publikisht “Përgjigje e Idriz Balajt ndaj Mocionit të Prokurorit për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis”.⁶ Më 9 nëntor 2011, Haradinaj paraqiti publikisht “Përgjigje e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis”.⁷

II. PARASHTRIME

A. Mocioni

4. Prokurori i kërkon Dhomës shfuqizimin e vërejtjes së dhënë kryeavokatit të Prokurorisë në rigjykimin *Haradinaj dhe të tjerët*.⁸ Ai “pranon masat e urdhëruara dhe vlefshmërinë e qëllimit të Dhomës për të garantuar gjykim të drejtë”, por kërkon rishikimin e natyrës së vërejtjes, në veçanti faktin se ajo i drejtohet personalisht z. Rogers dhe jo Prokurorit apo Zyrës së Prokurorisë.⁹

⁴ Vendimi i Apeluar, para. 71.

⁵ Prokurori k. *Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Lahi Brahimajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis, (“Përgjigje e Brahimajt”).

⁶ Prokurori k. *Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Idriz Balajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis, 8 nëntor 2011, (“Përgjigje e Balajt”).

⁷ Prokurori k. *Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për rishikimin e masës zhdëmtuese urdhëruar sipas Rregullës 68bis, 9 nëntor 2011 (“Përgjigje e Haradinajt”).

⁸ Mocioni, para. 20.

⁹ Mocioni, para. 1.

1. Pretendimi për arsyetim të gabuar

5. Prokurori argumenton se arsyetimi i Dhomës ishte qartësisht i gabuar kur ajo veptoi në përputhje me Rregullën 68bis,¹⁰ për arsye se dhënia e vërejtjes një personi është jashtë kompetencave të Dhomës sipas kësaj dispozite.¹¹

6. Prokurori parashtron se Dhoma mund t'i japë vërejtje vetëm “Prokurorisë si palë në një çështje, apo Prokurorit”.¹² Ai argumenton se Dhoma mund të ndërmarrë sanksione sipas Rregullës 68bis vetëm kundër “një pale” që nuk i përmbush detyrimet e Rregullës 68, dhe jo kundër individëve.¹³ Prokurori parashtron se përkufizimi i “palës” parashtruar në Rregullën 2 përfshin “Prokurorin dhe Mbrojtjen”.¹⁴ Ai argumenton se “Prokurori” do të thotë “Prokurori i emëruar sipas Nenit 16 të Statutit”.¹⁵ Ai parashtron se praktika e Tribunalit ndaj shkeljeve të Rregullës 68 “njeh mjete ligjore korrigjuese kur është e nevojshme për të garantuar gjykim të drejtë”,¹⁶ porse Rregulla 68bis nuk parashikon që individëve t'u ngarkohet përgjegjësi e as përmban garancitë e nevojshme për një proces të tillë.¹⁷

7. Prokurori pohon se ky argument mbështetet edhe nga jurisprudenca e TPNJ-së dhe TPNR-së në aspektin që të dy gjykatat vazhdimisht i drejtohen Prokurorisë si tërësi kur shqyrtojnë përmbushjen e detyrimeve të nxjerrjes së materialeve.¹⁸ Parashtrrohet se ky

¹⁰ Mocioni, sh. 3, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 26, 44, 64, 71.

¹¹ Mocioni, para. 6.

¹² Mocioni, para. 7, 8.

¹³ Mocioni, para. 7, 8.

¹⁴ Mocioni, para. 7.

¹⁵ Mocioni, para. 7, i referohet Rregullës 2 të Rregullores dhe Nenit 16 të Statutit të Tribunalit (“Statuti”). Prokurori gjithashtu argumenton se termat “Prokuror” dhe “Prokurori” përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme në jurisprudencën e TPNJ-së dhe TPNR-së, dhe se përkufizimet e tyre i referohen “funksionit dhe/ose mbajtësit të funksionit të caktuar nga Statuti”. Mocioni, sh. 8.

¹⁶ Mocioni, para. 9, i referohet *Prokurori k. Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Vendim në lidhje me ankesat e vazhdueshme për mospërmbushje prej Prokurorisë të detyrimeve të Rregullës 68 të Rregullores, 13 dhjetor 2005 (“Vendimi Oriq i 13 dhjetorit 2005”), para. 32; *Prokurori k. Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, para. 76, 77; *Prokurori k. Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes në lidhje me mospërmbushjen prej Prokurorisë të detyrimeve të Rregullës 68, 27 tetor 2005 (“Vendimi Oriq i 27 tetorit 2005”), f. 3, 5.

¹⁷ Mocioni, para. 9.

¹⁸ Mocioni, para. 8, 10, 11, i referohet *Prokurori k. Bagosora dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-41-AR73 dhe ICTR-98-41-AR73(B), Vendim në lidhje me Apelimin e Ndërkohshëm të Vendimit mbi urdhrat për mbrojtjen e dëshmitarëve, 6 tetor 2005, para. 43; *Prokurori k. Ndindilyimana dhe të tjerëve*, Lënda Nr.

argument vlen madje edhe në rastin e shkeljes së detyrimit të nxjerrjes së materialit prej një individi konkret.¹⁹

8. Prokurori thekson se kërkesa e Mbrojtjes për dhënie të vërejtjes personale është bërë në përputhje me Rregullën 68*bis* mirëpo argumentet e palëve mbështeten në Rregullën 46.²⁰ Për këtë arsye, Prokurori argumenton se Dhoma nuk mori parashtrime të qarta prej palëve në lidhje me këtë pikë.²¹ Për më tepër, Prokurori argumenton se burimi i cituar në mbështetje të caktimit të masës së vërejtjes është, ose i një date më të hershme se ajo e miratimit të Rregullës 68, ose i marrë nga gjykata të tjera që nuk kanë një dispozitë të barasvlershme.²² Ai gjithashtu parashtron se ky burim konfirmon parimin se sanksionet për mospërbushje të detyrimit të nxjerrjes së materialit duhet të merren kundër një pale dhe jo një individi.²³

9. Prokurori pretendon se shkelja e detyrimit të nxjerrjes së materialeve mund të përbëjë sjellje kundërvajtëse të një individi sipas Rregullës 46, por se një gjë e tillë është e rrallë dhe mund të ndodhë vetëm në rast se sjellja e individit është e papërshtatshme me fjalët të tjera kur përbën shkelje të qëllimshme apo keqdashëse të detyrimit të nxjerrjes së

ICTR-00-56-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për shkelje të pretenduara të detyrimit të Prokurorisë sipas Rregullës 69, 22 shtator 2008, (“Vendim *Ndindilyimana dhe të tjerët* i datës 22 shtator 2008”), para. 22, 59, 61; *Prokurori k. Karemera dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-44-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit RPF dhe vendosjen e sanksioneve ndaj Prokurorisë, 19 tetor 2006 (“Vendimi *Karemera* i 19 tetorit 2006”), para. 17, sh. 30; *Prokurori k. Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Vendim në lidhje me pretendimet për mospërbushje prej Prokurorisë të detyrimeve për nxjerrje materiali bazuar në Rregullën 66(B) dhe 68(i), 29 shtator 2005, f. 3; *Prokurori k. Furunxhisë*, Lënda Nr. IT-95-17/1-T, Vendim, 16 korrik 1998 (“Vendimi *Furunxhija* i 16 korrikut 1998”), para. 16.

¹⁹ Mocioni, para. 10, i referohet Vendimit *Furunxhija* të 16 korrikut 1998, para. 10, 16.

²⁰ Mocioni, para. 6, 10, i referohet *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-T, Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes për për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68*bis*, 12 shtator 2011 (Mocioni i Rregullës 68”), para. 3, 10-12; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84*bis*-T, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për për masë zhdëmtuese kundër shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për sanksione sipas Rregullës 68*bis*, 20 shtator 2011 (“Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Rregullës 68”), para. 28.

²¹ Mocioni, para. 6.

²² Mocioni, para. 10, i referohet Cainnech Lussiaa dhe Kate Gibson, “Disclosure of Evidence” në Karim A.A. Khan *et al* (eds) *Principles of Evidence in International Criminal Justice* (Oxford University Press: Oxford, 2010), f. 337.

²³ Mocioni, para. 10.

materialeve.²⁴ Prokurori argumenton se në çështjen *Kërstiq*, Dhoma e Apelit “nuk ishte e gatshme të vepronte sipas Rregullës 46” jashtë rrethanave të tilla.²⁵ Prokurori thekson se “modeli *Kërstiq*” i zhdëmtimit të shkeljeve të detyrimeve për nxjerrjen e materialeve nëpërmjet masave të Rregullës 68bis kundër “Prokurorit, dhe jo kundër përfaqësuesit konkret të Prokurorisë në një çështje”, është zbatuar më pas në Tribunal.²⁶

2. Pretendimi për nevojën e shmangies së padrejtësisë

10. Prokurori më tej parashtrohet se rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur çdo padrejtësi, për arsye se dhënia e vërejtjes nënkupton shpërdorim të detyrës zyrtare prej një personi kur në fakt Mbrojtja nuk pretendoi një sjellje të tillë²⁷ dhe Dhoma nuk konkludoi se kryeavokati i Prokurorisë kishte vepruar me keqdashje.²⁸

11. Prokurori parashtrohet se “garancitë procedurale” duhet të shoqërojnë vendosjen e sanksioneve kundër një personi, dhe se në rastin konkret kjo nuk ndodhi.²⁹ Prokurori thekson se dhënia e vërejtjes një personi përbën sanksion sipas Rregullës 46³⁰ dhe se avokatët kundër të cilëve vendosen sanksione sipas Rregullës 46 gëzojnë dhe mbrojtjen e nevojshme që u mundëson kjo rregull.³¹ Në veçanti, Prokurori argumenton se para vendosjes së sanksioneve, avokatët duhet të paralajmërohen qartë për sanksionet e afërta dhe se atyre duhet t’u jepet mundësia që të shpjegojnë sjelljen e tyre dhe të kërkojnë ndjesë.³² Prokurori më tej parashtrohet se Dhoma mund të informojë shoqatën profesionale

²⁴ Mocioni, para. 12, 13, i referohet Rregullës 46(A); *Prokurori k. Karemera dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-44-T, Vendim mbi Kërkesën e Rregullës 68(D) paraqitur prej Prokurorisë dhe Njoftimin e dymbëdhjetë të Joseph Nzirorera për shkelje të Rregullës 68, 26 mars 2009, para. 20, 24, 26, 27, dhe f. 11; *Prokurori k. Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykimi i Apelit, para. 174, 175, 188, 211.

²⁵ Mocioni, para. 13, i referohet *Prokurori k. Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykimi i Apelit, 19 prill 2004, para. 213-215. *Shih* gjithashtu Mocioni, sh. 28, i referohet *Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Aktgjykimi i Apelit, 29 korrik 2004, para. 299, sh. 604.

²⁶ Mocioni, para. 14.

²⁷ Mocioni, para. 16, i referohet Mocionit të Rregullës 68, para. 12, 21, 26, 32; Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Rregullës 68, para. 11; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, gusht 2011, Çështje Procedurale, T. 887.

²⁸ Mocioni, para. 15-16, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 56-60, 63.

²⁹ Mocioni, para. 9, 15, 18, 19.

³⁰ Mocioni, para. 17.

³¹ Mocioni, para. 18, i referohet Rregullës 46(A).

³² Mocioni, para. 18, i referohet Rregullës 46(A); *Prokurori k. Nzabonimana*, Lënda Nr. ICTR-98-44D-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për rishikim dhe/ose Leje për Apelim të vendimit të Dhomës

në shtetin ku avokati ushtron profesionin në lidhje me shkeljen e tij vetëm me miratimin e Kryetarit të Tribunalit.³³ Prokurori argumenton se kryeavokatit të Prokurorisë nuk iu ofruan këto masa mbrojtëse dhe se për këtë arsye rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur çfarëdo padrejtësie.³⁴

B. Përgjigjet

12. Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj argumentojnë se Prokurori nuk ka paraqitur asnjë arsye që do të përligjte rishikimin e objektit të vërejtjes dhe se Dhoma nuk gaboi kur mori Vendimin e Apeluar.³⁵ Për këto arsye, ata parashtrojnë se Mocioni duhet të refuzohet.³⁶ Ndryshe, Brahimaj i kërkon Dhomës të miratojë pjesërisht Mocionin e Prokurorit dhe t'i japë vërejtje Prokurorit, z. Brammertz, në përputhje me Rregullën 68*bis*, për shkelje të rënda të Rregullës 68 të kryera prej z. Rogers dhe për mosushtrimin e kontrollit të duhur mbi punonjësit e tij përsa i përket respektimit të Rregullës 68.³⁷

13. Balaj dhe Brahimaj parashtrojnë se në Përgjigjen e tij ndaj Mocionit të Mbrojtjes sipas Rregullës 68³⁸ apo të paktën më 23 shtator 2012, 14 ditë pas paraqitjes së Mocionit të Mbrojtjes sipas Rregullës 68,³⁹ Prokurori duhej të kishte trajtuar siç duhej çështjen e sanksioneve kundër një personi sipas Rregullës 68*bis*. Sipas tyre, Mocioni duhet të refuzohet si përpjekje e Prokurorit për të korrigjuar në mënyrë të papërshtatshme mosparaqitjen prej tij të argumenteve të duhura në parashttrimet e mëparshme.⁴⁰ Haradinaj dhe Balaj parashtrojnë se z. Rogers pati mundësinë që të paraqiste argumentet

Gjyqësore për paralajmërimin e Prokurorisë bazuar në Rregullën 46, 15 qershor 2011, para. 29, f. 9; *Prokurori k. Ntawukulilyayo*, Lënda Nr. ICTR-05-82-T, Vendim gojor për paralajmërim të Prokurorisë, 6 maj 2009.

³³ Mocioni, para. 18, i referohet Rregullës 46(B).

³⁴ Mocioni, para. 15, 17, 18.

³⁵ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 9; Përgjigje e Balajt, para. 1; Përgjigje e Brahimajt, para. 34.

³⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 18; Përgjigje e Balajt, para. 39; Përgjigje e Brahimajt, para. 1, 35.

³⁷ Përgjigje e Brahimajt, para. 36.

³⁸ Përgjigje e Brahimajt, para. 9-11, i referohet Përgjigjes së Prokurorisë të Rregullës 68, para. 9-21, 26-29.

³⁹ Përgjigje e Brahimajt, para. 12, i referohet Rregullës 126*bis*.

⁴⁰ Përgjigje e Brahimajt, para. 12-13; *shih* gjithashtu Përgjigje e Balajt, para. 12, i referohet *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.16, Vendim mbi Apelimin e ndërkohshëm të Jadranko Përliqit të Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për rishikimin e Vendimit për pranimin e provave dokumentare, 3 nëntor 2009 ("Vendimi i Apelit Përliq i datës 3 nëntor 2009"), f. 3.

e tij në lidhje me këtë çështje,⁴¹ siç theksohet në Vendimin e Apeluar.⁴² Ata deklarojnë se gjatë seancës gjyqësore më 1 shtator 2011, z. Rogers pranoi shprehimisht “natyrën tejet personale” të kërkesave të Mbrojtjes në lidhje me sjelljen e tij dhe atij iu lejua që të paraqiste parashtrimet e tij me shkrim,⁴³ dhe se në parashtrimet e tij gojore dhe me shkrim ai thjesht argumentoi se nuk duhet të vendosen sanksione sipas Rregullës 68bis, duke iu referuar disa prej çështjeve të cituara në këtë Mocion.⁴⁴

14. Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj parashtrojnë se Prokurori gabon kur deklaroi se Rregulla 68 i mundëson Dhomës vendosjen e sanksioneve kundër Zyrës së Prokurorisë si organ i Tribunalit apo kundër vetë Prokurorit, por jo kundër përfaqësuesve të veçantë të Prokurorisë.⁴⁵ Argumentet e tyre konkrete shtjellohen më poshtë:

1. Kompetencat e Dhomës bazuar në Rregullën 68bis

15. Haradinaj dhe Brahimaj argumentojnë se Rregulla 68bis i mundëson Dhomës kompetencë të gjerë për marrjen e masave dhe vendosjen e sanksioneve dhe i lejon marrjen e vendimit në lidhje me sanksionet më të përshtatshme rast pas rasti.⁴⁶ Haradinaj pretendon se nuk ka ndonjë dispozitë e as Prokurori vetë nuk ka cituar jurisprudencë që ndalon masën e dhënies së vërejtjes një avokati të Prokurorisë.⁴⁷ Ai parashtron se Rregulla 68bis i lejon Dhomës vendosjen e sanksioneve kundër cilëso palë të procesit⁴⁸ dhe se z. Rogers si avokat i Prokurorisë është palë e procesit.⁴⁹

⁴¹ Përgjigje e Haradinajt, para. 4, 10; Përgjigje e Balajt, para. 33, 34, 36, 37.

⁴² Përgjigje e Balajt, para. 34, 35, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 2-24; i referohet *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Çështje procedurale, 31 gusht 2011, T. 879-900.

⁴³ Përgjigje e Haradinajt, para. 4; Përgjigje e Balajt, para. 37, i referohet *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Çështje procedurale, 1 shtator 2011, T. 999, T. 1004.

⁴⁴ Përgjigje e Haradinajt, para. 10, i referohet *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Çështje procedurale, 1 shtator 2011, T. 1001-1004; Përgjigje e Prokurorisë e Rregullës 68, para. 26-29. *Shih* gjithashtu Përgjigje e Balajt, para. 35, 36.

⁴⁵ Përgjigje e Haradinajt, para. 9; Përgjigje e Balajt, para. 14, i referohet Mocionit, para. 7-8; Përgjigje e Brahimajt, para. 20, 24.

⁴⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 9, i referohet Mocionit, para. 8 ku citohet Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 212; Përgjigje e Brahimajt, para. 33.

⁴⁷ Përgjigje e Haradinajt, para. 9.

⁴⁸ Përgjigje e Haradinajt, para. 9.

⁴⁹ Përgjigje e Haradinajt, para. 9.

16. Balaj parashtron se Dhoma Gjyqësore veprimi plotësisht në përputhje me Rregullën 68bis sipas të cilës Dhoma mund të vendosë “*proprio motu* ose me kërkesë të cilësdo palë, në lidhje me sanksionet ndaj palës që nuk i përmbush detyrimet për nxjerrje materiali në bazë të Rregullores”.⁵⁰ Balaj parashtron se në praktikë, prokurorët që caktohen në një çështje janë personalisht përgjegjës për përmbushjen e detyrimit për nxjerrje materiali bazuar në Rregullën 68bis.⁵¹ Ai argumenton se kur Dhoma konkludon se janë kryer shkelje të vazhdueshme të Rregullës 68, në Rregullën 68bis nuk ekziston asnjë formulim që e pengon Dhomën të marrë masa ndaj një prokurori konkret i cili është personalisht përgjegjës për shkelje të tilla.⁵² Balaj argumenton se nuk është logjike të konkludohet se nuk mund të vendosen sanksione kundër avokatit të Prokurorisë në këtë çështje vetëm për arsye se në vendimet e tyre të mëparshme TPNJ-ja dhe TPNR-ja kanë vendosur sanksione kundër “Prokurorisë” apo “Prokurorit” për shkelje të detyrimit për nxjerrje materiali.⁵³

1. Garancitë procedurale të Rregullës 68bis përkundrejt Rregullës 46

17. Brahimaj argumenton se z. Rogers iu dha vërejtje bazuar në Rregullën 68bis dhe se, as Rregullorja, as jurisprudenca nuk kushtëzojnë që personit të ndëshkuar sipas Rregullës 68bis, duhet t’i ofrohen “garancitë” e Rregullës 46.⁵⁴ Brahimaj thekson se duhet të bëhet dallim midis Rregullës 46 dhe Rregullës 68bis në lidhje me nevojën për garanci procedurale për shkak të rreptësisë së sanksioneve që disponon Dhoma bazuar në dispozitën e mëparshme.⁵⁵ Sipas tij, Rregulla 68bis i mundëson Dhomës vendosjen e sanksioneve më të përshtatshme rast pas rasti, dhe duke marrë parasysh dallimet midis Rregullës 46 dhe Rregullës 68bis, “garancitë” që përmend Prokurori nuk janë të domosdoshme në rastet kur vepohet në përputhje me Rregullën 68bis.⁵⁶

⁵⁰ Përgjigje e Balajt, para. 16-17.

⁵¹ Përgjigje e Balajt, para. 18.

⁵² Përgjigje e Balajt, para. 19. Balaj thekson se Rregulla 68bis në veçanti parashtron se Dhoma mund të vendosë për sanksione konkrete ndaj një pale dhe këtë mund ta bëjë *proprio motu* (Përgjigje e Balajt, para. 20).

⁵³ Përgjigje e Balajt, para. 21, 22.

⁵⁴ Përgjigje e Brahimajt, para. 30, i referohet Mocionit, para. 17-19.

⁵⁵ Përgjigje e Brahimajt, para.32.

⁵⁶ Përgjigje e Brahimajt, para. 33. Shih gjithashtu Përgjigje e Balajt, para. 32.

18. Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj më tej parashtrojnë se është i pavend referimi që i bën Prokurori Rregullës 46, për arsye se Dhoma e ka marrë vendimin bazuar në Rregullën 68bis.⁵⁷ Brahimaj argumenton se Rregulla 68bis mundëson mekanizmin e duhur dhe se rrethanat e Rregullës 46 kur një avokat në përgjithësi kryen sjellje fyese dhe shpërdoruese,⁵⁸ nuk mund të krahasohen me rrethanat e Vendimit të Apeluar, ku “avokati [...] nuk e bëri si duhet detyrën e tij si përfaqësues i ligjit për arsye se kreu shkelje flagrante dhe të vazhdueshme të të drejtës së të Akuzuarve për gjykim të drejtë duke mos nxjerrë materiale të Rregullës 68.”⁵⁹

19. Brahimaj parashton se Rregulla 68bis nuk kushtëzon që pala shkelëse duhet të ketë vepruar me keqdashje”,⁶⁰ dhe se Vendimi i Apeluar nuk shkakton kurrfarë padrejtësie në lidhje me ndonjë insinuatë për shpërdorim të pozitës zyrtare.⁶¹

20. Sipas Balajt, argumentet e Prokurorit në lidhje me mundësinë e raportimit të sjelljes së Z. Rogers në shoqatën profesionale të shtetit ku ai ushtron profesionin e tij si masë bazuar në Rregullën 46, nuk janë të vlefshme për Mocionin aktual⁶² ku kërkohet rishikimi i masës së dhënies së vërejtjes bazuar në Rregullën 68bis.⁶³ Për më tepër, ai parashton se Prokurori nuk e kundërshton faktin se vërejtja publike është sanksion në kompetencë të Dhomës bazuar në Rregullën 68bis.⁶⁴

2. Përkufizimi i “palëve” në Rregullën 2

21. Sipas Balajt, Rregulla 2 nuk i kufizon kompetencat e Dhomës brenda Rregullës 68bis për t’i dhënë vërejtje një përfaqësuesi konkret të Prokurorisë.⁶⁵ Duke marrë parasysh

⁵⁷ Përgjigje e Haradinajt, para. 9; Përgjigje e Balajt, para. 27, i referohet Mocionit, para. 10 ku citohet Vendimi *Karemera* i 19 tetorit 2006; Përgjigje e Brahimajt, para. 30, 31.

⁵⁸ Përgjigje e Brahimajt, para. 31.

⁵⁹ Përgjigje e Brahimajt, para. 31.

⁶⁰ Përgjigje e Brahimajt, para. 28, i referohet Rregullës 68bis; *Prokurori k. Stakiqit*, Lënda Nr. IT-97-24, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, 22 mars 2006, para. 190.

⁶¹ Përgjigje e Brahimajt, para. 28, i referohet Mocionit, para. 16; Përgjigje e Brahimajt, para. 29.

⁶² Përgjigje e Balajt, para. 38, i referohet Mocionit, para. 8.

⁶³ Përgjigje e Balajt, para. 38.

⁶⁴ Përgjigje e Balajt, para. 2, i referohet Mocionit, para. 8.

⁶⁵ Përgjigje e Balajt, para. 26.

mungesën e një organi të barasvlershëm të mbrojtjes që do të mund të ndëshkohej me sanksione si tërësi për shkak të sjelljes së një avokati të mbrojtjes,⁶⁶ Balaj parashtron se në rast se një avokat i mbrojtjes do të kryente shkelje të detyrimit për nxjerrje materiale, ai do të mbante personalisht përgjegjësi dhe do t'i jepej vërejtje si individ.⁶⁷ Brahimaj parashtron se dhënia e imunitetit për sanksionet e Rregullës 68*bis* një avokati individual të Prokurorisë përbën shkelje të parimit të “barazisë së palëve”.⁶⁸

22. Brahimaj parashtron se megjithëse detyrimi i nxjerrjes së materialeve sipas Rregullës 68 teknikisht është i Prokurorit, zbatues të detyrimit janë ata që ai i cakton si “kryeavokatë të Prokurorisë”.⁶⁹ Brahimaj argumenton se Dhoma duhet të ketë kompetenca për të nxjerrë para përgjegjësisë palën para Dhomës dhe që kryen këto detyra.⁷⁰ Ai argumenton se çdo përfundim tjetër do t'i pamundësonte Dhomës kompetencat efektive për parandalimin e shkeljeve të detyrimit të nxjerrjes së materialeve prej Prokurorisë⁷¹ nëqoftëse do të lejonte që “Zyra e Prokurorisë si organ të marrë përsipër fajin për shkeljet e rënda dhe të vazhdueshme të Rregullës 68 të kryera prej z. Rogers dhe të eliminonte çfarëdo përgjegjësie personale në Zyrën e Prokurorisë.”⁷² Sipas Brahimajt, kjo do të ishte në kundërshtim me Statutin dhe interesat e drejtësisë.⁷³

23. Brahimaj argumenton se ndryshe, nëqoftëse Dhoma do ta pranonte se në përputhje me Rregullën 2, ‘pala’ që përmendet në Rregullën 68*bis* është Prokurori, në atë rast vërejtja për shkeljet e Rregullës 68*bis* të kryera nga z. Rogers duhet t'i jepet Prokurorit. Brahimaj thekson se Prokurori nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë duke e

⁶⁶ Përgjigje e Balajt, para. 26.

⁶⁷ Përgjigje e Balajt, para. 26.

⁶⁸ Përgjigje e Brahimajt, para. 26-27.

⁶⁹ Përgjigje e Brahimajt, para. 20.

⁷⁰ Përgjigje e Brahimajt, para. 20.

⁷¹ Përgjigje e Brahimajt, para. 2, 22.

⁷² Përgjigje e Brahimajt, para. 2, 22-23. Brahimaj gjithashtu pretendon se dhënia e vërejtjes Prokurorit është “e ngjashme me dhënien vërejtje Shoqatës së Avokatëve të Mbrojtjes të TPNJ-së për sjellje të papërshtatshme të një avokati të mbrojtjes” (Përgjigje e Brahimajt, para. 24). Brahimaj parashtron se në Angli dhe Uells, nëqoftëse një avokat që kryen detyrën në emër të Kryeprokurorit shkel një urdhër të gjykatës, gjykata i jep vërejtje avokatit që kryen detyrën e prokurorit dhe jo Kryeprokurorit (Përgjigje e Brahimajt, para. 21).

⁷³ Përgjigje e Brahimajt, para. 2.

lejuar Zyrën e Prokurorisë që thjesht të marrë përsipër fajin për sjelljen jokorrekte të përfaqësuesve të saj.⁷⁴

4. Përgjegjësia e avokatëve të Prokurorisë si individë para Tribunalit

24. Haradinaj parashtron se parandalimi i shkeljeve të mëtejshme ishte shqetësimi kryesor i Dhomës kur ajo mori Vendimin e Apeluar⁷⁵ dhe argumenton se pavarësisht nëse objekti i vërejtjes është z. Rogers si avokat i Prokurorisë apo Prokuroria si palë, pikërisht z. Rogers kreu shkelje të detyrimit për nxjerrje materialesh dhe ai është personi i cili duhet të zbatojë masat e Dhomës Gjyqësore, dhe përgjegjës për përmbushjen e detyrimit të Prokurorisë për nxjerrje të materialeve deri në fund të çështjes.⁷⁶

25. Haradinaj parashtron se avokatët e Prokurorisë të ngarkuar për procedimin e një çështjeje duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, duke përfshirë dhe kryerjen e procesit që mbikëqyret prej tyre në një çështje.⁷⁷ Haradinaj u referohet Standardeve të Sjelljes Profesionale për Avokatë të Prokurorisë ku thuhet se kundër ‘avokatëve të prokurorisë’ mund të vendosen sanksione, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren.⁷⁸ Haradinaj gjithashtu parashtron se sipas Kodi i Sjelljes i Shoqatës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit (‘Kodi i Sjelljes’) ‘gjatë zbatimit të detyrave që i caktohen, avokati i prokurorisë [...] gjithmonë duhet të ketë parasysh se personi përgjegjës për paraqitjen e dhe procedimin e çështjes është ai vetë’,⁷⁹ dhe se si avokat nga Anglia, z. Rogers është nën detyrimin edhe të këtij Kodi të Sjelljes.⁸⁰ Haradinaj parashtron se sipas Kodit të Sjelljes, avokatët e prokurorisë mbajnë përgjegjësi individuale për veprimet e tyre në

⁷⁴ Përgjigje e Brahimajt, para. 25.

⁷⁵ Përgjigje e Haradinaj, para. 8, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 57.

⁷⁶ Përgjigje e Haradinaj, para. 8.

⁷⁷ Përgjigje e Haradinaj, para. 12.

⁷⁸ Përgjigje e Haradinaj, para. 12, 14. Lidhur me këtë, Haradinaj u referohet Standardeve të Sjelljes Profesionale për Avokatë të Prokurorisë, Rregullorja e Prokurorit Nr. 2 (1999) (“Standardet e Prokurorisë për Sjellje Profesionale”) të lëshuara nga Prokurori. Haradinaj argumenton se Standardet e Prokurorisë për Sjellje Profesionale zbatohen në lidhje me avokatë që përfaqësojnë çështjen e Prokurorisë para TPNJ-së në emër të Prokurorit, si për shembull z. Rogers (Përgjigje e Haradinaj, para. 12, u referohet Standardeve të Prokurorisë për Sjellje Profesionale, para. 4)

⁷⁹ Përgjigje e Haradinaj, para. 15, i referohet Kodi i Sjelljes i Shoqatës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, Pjesa 3; Standarde me shkrim lidhur me ushtrimin e detyrës profesionale, para. 10.2.

⁸⁰ Përgjigje e Haradinaj, para. 12.

çështjet që paraqesin dhe se Kodi parashikon dhënien e vërejtjes si një nga sanksionet e mundshme.⁸¹

26. Haradinaj gjithashtu parashtroi se në Mocion, Prokurori nuk bën të ditur nëse do të marrë masa kundër z. Rogers.⁸² Haradinaj argumenton se Standardet e Prokurorisë të Sjelljes Profesionale parashikojnë marrjen e masave disiplinore dhe thekson se në jurisprudencë është pranuar se Prokurori mund të konsiderohet organ disiplinor për avokatë të prokurorisë.⁸³

27. Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj argumentojnë se në rrethanat e atëhershme ishte e arsyeshme që z. Rogers t'i jepej vërejtje.⁸⁴ Sipas Haradinajt vërejtja ishte e arsyeshme për të garantuar mospërsëritjen e shkeljeve të Rregullës 68 me dëshmitarët e mbetur të rigjykit për të cilët z. Rogers ka detyrimin e nxjerrjes së të gjitha materialeve.⁸⁵ Ai parashtroi se ky shqetësim ishte tejet i rëndësishëm në kohën kur u mor Vendimi i Apeluar duke marrë parasysh rrethanat e atëhershme, veçanërisht në lidhje me Dëshmitarin 81.⁸⁶ Brahimaj deklaroi se Prokuroria vazhdon të mos paraqesë materiale të Rregullës 68 në lidhje me të cilat ai dhe Haradinaj kanë paraqitur parashtrime.⁸⁷

28. Balaj argumenton se bazuar në Vendimin e Apeluar është e qartë se vërejtja që iu dha z. Rogers ishte rezultat i disa faktorëve që karakterizuan mënyrën e tij të procedimit, duke përfshirë 'interpretimin papërshtatshmërisht të ngushtë të Rregullës 68 prej tij' që 'për pasojë mund të shkaktojë padrejtësi të tjera për Mbrojtjen përse i përket mosnxjerrjes prej Prokurorisë të materialeve të ngjashme të Rregullës 68 në lidhje me dëshmitarë të

⁸¹ Përgjigje e Haradinajt, para. 15, 16, i referohet Kodi i Sjelljes i Shoqatës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, Pjesa 3; Standarde me shkrim lidhur me ushtrimin e detyrës profesionale, Pjesa 2, Shtojcat e Kodit, Shtojca K, Rregullorja e gjykatës disiplinore, 2009, 19(2)(j) (rregullat e parashtruara në shtojcën e Kodit parashikojnë vërejtjen personale si sanksion të mundshëm.)

⁸² Përgjigje e Haradinajt, para. 13;

⁸³ Përgjigje e Haradinajt, para. 13, i referohet Vendimit *Karemera* të 19 tetorit 2006, para. 17.

⁸⁴ Përgjigje e Haradinajt, para. 17; Përgjigje e Balajt, para. 23, 24; Përgjigje e Brahimajt, para. 33.

⁸⁵ Përgjigje e Haradinajt, para. 17.

⁸⁶ Përgjigje e Haradinajt, para. 17. *Shih* gjithashtu Përgjigje e Brahimajt, para. 33.

⁸⁷ Përgjigje e Brahimajt, para. 15, i referohet Përgjigje e Brahimajt lidhur me Zgjatjen e Afatit të Përgjigjes; Përgjigje e Haradinajt lidhur me Zgjatjen e Afatit të Përgjigjes; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë për Leje për Kundërpërgjigje dhe për Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt për nxjerrje urgjente të materialit shfaqësues në lidhje me Dëshmitarin 81, 26 tetor 2011, *shih* gjithashtu Përgjigje e Brahimajt, para. 33.

tjerë’,⁸⁸ refuzimin e tij për të ‘pranuar rëndësinë e dukshme të provave,’⁸⁹ këmbënguljen e tij të vazhdueshme dhe jobindëse se materialet nuk kishin lidhje me besueshmërinë e Dëshmitarit 75,⁹⁰ dhe ‘mosgatishmërinë e tij për të pranuar shkeljet e rregullës të kryera prej tij’⁹¹. Balaj parashtroi se Dhoma kishte kompetencë për të vendosur në lidhje me këto aspekte duke i dhënë vërejtjen përkatëse z. Rogers.⁹²

III. LIGJI PËRKATËS

A. Kërkesa për rishqyrtim

29. Dhoma ka analizuar ligjin përkatës në lidhje me kërkesat për rishikim në “Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për rishikimin e Vendimit të shumicës për mospranimin e dokumentit të Rregullës 65ter numër 03003 ose ndryshe për lejimin e apelimit të Vendimit të Shumicës me Mendimin pjesërisht mospajtues të gjykatësit Delvoie” lëshuar më 27 shkurt 2012 (“Vendimi i 27 shkurtit 2012”).⁹³ Në të theksohet se Dhoma mund të rishikojë një vendim të saj kur është bindur se vendimi i saj i mëparshëm ka qenë i gabuar apo ka shkaktuar padrejtësi⁹⁴ dhe, më tej, se parimi i përfundimësisë kërkon ushtrimin me masë të kompetencave për rishikimin e vendimeve të mëparshme.⁹⁵

B. Masat zhdëmtuese për shkelje të detyrimit të nxjerrjes së materialeve

30. Dhoma e Apelit ka konkluduar se shkeljet e detyrimit të nxjerrjes së materialeve nga ana e Prokurorisë sipas Rregullores, shqyrtohen në bazë të Rregullave 46 dhe 68bis.⁹⁶

⁸⁸ Përgjigje e Balajt, para. 23, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 57, 59.

⁸⁹ Përgjigje e Balajt, para. 23, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 63.

⁹⁰ Përgjigje e Balajt, para. 23, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 63.

⁹¹ Përgjigje e Balajt, para. 23, i referohet Vendimit të Apeluar, para. 64.

⁹² Përgjigje e Balajt, para. 24.

⁹³ Vendim i 27 shkurtit 2012, para. 11-12.

⁹⁴ *Prokurori k. Galiqit*, IT-98-29-AR73, Vendim lidhur me Kërkesën e Prokurorisë për Leje për Apelim, 14 dhjetor 2001, para. 13; *Prokurori k. Muciqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-96-21Abis, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 8 prill 2003 (“Aktgjykimi i Apelit të Dënimit Muciq”), para. 49.

⁹⁵ Vendim i 27 shkurtit 2012, para. 12, citon *Prokurori k. Semanza*, Lënda Nr. ICTR-97-20-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për rishikim të Vendimit për mosmiratimin e lejes për thirrjen e dëshmitarëve të kundërprovave të Mbrojtjes, 9 maj 2002, para. 8.

⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 188, 200, 211.

31. Rregulla 68*bis* parashtron:

Gjykatësi paragjyqësor ose Dhoma Gjyqësore mund të vendosë *proprio motu* ose me kërkesë të cilësdo palë, në lidhje me sanksionet ndaj palës që nuk i përmbush detyrimet për nxjerrje materiali në bazë të Rregullores.

Dhoma e Apelit ka konkluduar Rregulla 68*bis* lidhet veçanërisht me detyrimin për nxjerrje materiali dhe i mundëson Tribunalit kompetenca të gjera për vendosjen e sanksioneve ndaj palës që ka kryer shkeljen, edhe *proprio motu* nëse është e nevojshme.⁹⁷

32. Rregulla 46 e Rregullores konkretisht parashtron:

(A) Nëqoftëse një gjykatës ose një Dhomë konkludon se sjellja e një avokati është fyese, shpërdoruese ose ndryshe pengon zhvillimin e duhur të procesit, ose se avokati është shpërfillës ose ndryshe nuk e përmbush standardin e kompetencës dhe etikës profesionale gjatë kryerjes së detyrës, pasi e ka paralajmëruar avokatin, Dhoma mund:

- (i) të refuzojë praninë e avokatit para Dhomës; dhe/ose
- (ii) pasi i ka dhënë avokatit mundësinë për të shprehur mendimin e vet, të vendosë se avokati nuk është më i pranueshëm për përfaqësimin e të dyshuarit ose të akuzuarit para Tribunalit në bazë të Rregullave 44 dhe 45.

(B) Gjykatësi ose Dhoma gjithashtu, me miratimin e Kryetarit, mund ta informojë shoqatë profesionale në shtetin ku avokati e ushtron profesionin për çdo shpërdorim detyre prej avokatit [...].

33. Rregulla 46 ka për qëllim të trajtojë sjelljen fyese apo shpërdoruese, pengimin e zhvillimit të duhur të procesit, shpërfilljen apo mospërmbushjet e tjera të standardit të kompetencës dhe etikës profesionale.

⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 212.

IV. DISKUTIM

34. Fillimisht, Dhoma vëren se në Mocionin e Mbrojtjes të Rregullës 68, kur flet për sanksionet, Mbrojtja i referohet kompetencës bazuar në Rregullën 68, dhe konkretisht kërkoi që Dhoma t'i japë vërejtje Z. Rogers. Dhoma gjykon se një kërkesë e tillë e paralajmëron Prokurorinë mbi nevojën për të trajtuar çështjen e dhënies së mundshme të vërejtjes ndaj Z. Rogers sipas Rregullës 68bis. Aktualisht, Prokuroria pranon⁹⁸ se në Përgjigjen e saj ndaj Mocionit të Rregullës 68 të Mbrojtjes, nuk e trajtoi këtë çështje. Për këtë arsye, Dhoma konkludon se mostrajtimi prej Prokurorisë i çështjes së sanksioneve të mundshme ndaj Z. Rogers bazuar në Rregullën 68bis në një fazë të mëhershme është rezultat i gabimit të saj.

35. Prokuroria përpiqet të mbështetet në Rregullën 46(B) dhe parashtrohet se vërejtja publike kundër një avokati konkret faktikisht përbën raportim të sjelljes së tij kundërvajtëse në shoqatës profesionale të shtetit ku ai ushtron profesionin, pa miratimin e Kryetarit.⁹⁹ Dhoma nuk e pranon këtë argument. Pranimi i këtij argumenti të Prokurorisë do të nënkuptonte se një vendim për vendosjen e sanksioneve bazuar në Rregullën 46, është automatikisht konfidencial dhe se për paraqitjen e një vendimi të tillë publikikisht nevojitet miratimi i Kryetarit. Jurisprudenca nuk e mbështet këtë argument.¹⁰⁰ Për mendimin e Dhomës, informimi i shoqatës profesionale në shtetin ku avokati ushtron profesionin për shkeljen e kryer prej tij, paraqet një masë shtesë që mund të caktohet në një vendim publik apo konfidencial.

36. Dhoma gjykon se asnjë rregull nuk duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që të shkaktojë kundërshti me objektin apo qëllimin e një rregulle tjetër.¹⁰¹ Rregulla 68bis dhe Rregulla 46 kanë për qëllim t'i mundësojnë Dhomës zgjidhje të mundshme në lidhje me

⁹⁸ Mocioni, para. 6.

⁹⁹ Mocioni, para. 18.

¹⁰⁰ *Shih*, për shembull, *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Urdhër për dhënie të vërejtjes z. Karnavas, lëshuar publikisht më 15 qershor 2009; *Prokurori k. Gotovinës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-06-90-PT, Vendim mbi konstatimin e sjelljes shpërdoruese të avokatit Miroslav Sheparoviq, lëshuar publikisht më 6 maj 2007.

¹⁰¹ *Shih* Neni 31(1), Vienna Convention on the Law of Treaties/Konventa e Vjenës lidhur me Ligjin për Traktate.

sjelljet që pengojnë zhvillimin e duhur dhe të drejtë të procesit. Shumica, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Hall, gjykon se në kuptim të shkeljes së detyrimit për nxjerrje të materialit, Rregulla 68*bis* është *lex generalis* për sanksionet në lidhje me shkeljet e detyrimit për nxjerrje materiali dhe se shqyrtimi i një çështjeje të Rregullës 46 nga këndvështrimi i Rregullës 68*bis* bie ndesh me objektin dhe qëllimin e Rregullës 46. Ky përfundim mbështetet në arsyetimin e mëposhtëm:

37. Jurisprudenca tregon se është e mundshme që ndaj një avokati, i cili me veprimet e tij ka kryer shkelje të Rregullës 68, të zbatohet Rregulla 46 për shkak të sjelljes së tij, por kjo mund të ndodhë vetëm nëse “në rrethanat ekzistuese ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të dyshuar në korrektësinë” e avokatit përkatës.¹⁰² Nëqoftëse në bazë të Rregullës 68*bis* do të lejohej dhënia e vërejtjes për avokatin, atëherë do të mund të vendosej sanksion thuajse ligjërisht i njëjtë me një masë të marrë sipas Rregullës 46, pa pasur nevojë për përmbushjen e kriterit të Rregullës 46 sipas të cilit Dhoma duhet të bindet se sjellja e avokatit është fyese, shpërdoruese, penguese, shpërfillëse ose ndryshe nuk e përmbush standardin e kompetencës dhe etikës profesionale, gjë që do ta bënte Rregullën 46 të tepërt.

38. Megjithëse Rregulla 68*bis* nuk parashkruan ndonjë procedurë të veçantë, Rregulla 46 kushtëzon se sanksioni mund të vendoset vetëm “pasi avokati të jetë paralajmëruar siç duhet”.

39. Për më tepër, Rregulla 46 ka të bëjë me “sjelljen e një avokati”,¹⁰³ kurse Rregulla 68*bis* me shkeljet e detyrimit për nxjerrjen e materialit, midis të tjerash, me shkeljet e Rregullës 68. Rregulla 68 parashtron detyrime konkrete për Prokurorin të cilat mbulojnë më shumë se avokatë të caktuar që përfaqësojnë Prokurorin në një çështje.

¹⁰² *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 173, 174. Për ilustrim të sanksioneve sipas Rregullës 46 ndaj një avokati për shkeljet e tij të Rregullës 68 *shih* *Prokurori k. Karemera dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-44-T, Vendim mbi Kërkesën e Rregullës 68(D) paraqitur prej Prokurorisë dhe Njoftimin e dymbëdhjetë të Joseph Nziroera për shkelje të Rregullës 68, 26 mars 2009, para. 27.

¹⁰³ Rregulla 46(A) (me theks të shtuar).

40. Për këto arsye, Shumica konkludon se megjithëse një avokati mund t'i jepet vërejtje për shkelje të rënda të detyrimit për nxjerrje materiali, kërkesat për vendosjen e sanksioneve duhet të bëhen bazuar në Rregullën 46. Për të qenë të suksesshme, kërkesat duhet të verifikojnë përmbushjen e kriterëve thelbësorë të Rregullës 46 në vijim: se (i) sjellja e një avokati është fyese, shpërdoruese ose ndryshe pengon zhvillimin e duhur të procesit, ose ndryshe nuk e përmbush standardin e kompetencës dhe etikës profesionale; (ii) se në rrethanat ekzistuese ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të dyshuar në korrektësinë e avokatit përkatës; dhe (iii) se Dhoma *më parë* e ka paralajmëruar avokatin.

41. Kjo qasje është në përputhje me vendimet e Dhomave Gjyqësore dhe Dhomës së Apelit të këtij Tribunali dhe të TPNR-së, të cilat në përgjithësi kanë miratuar sanksione bazuar në Rregullën 68*bis* si mekanizëm për zhvillimin e rregullt të proceseve gjyqësore¹⁰⁴ dhe janë mbështetur në Rregullën 46 për sa i përket paralajmërimit apo vërejtjes si masa disiplinore në raste të shkeljeve të rënda të detyrimit për nxjerrje materiali.¹⁰⁵ Megjithëse këto të fundit në rrethanat konkrete të një çështjeje mund të

¹⁰⁴ *Prokurori k. Oriqit*, Lënda Nr. IT-03-68-T, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes në lidhje me mospërmbushjen prej Prokurorisë të detyrimeve të Rregullës 68, 27 tetor 2005, f. 3, ku konkludohet se “në jurisprudencën e Tribunalit, shkeljet e mundshme të Rregullës 68(i) nuk rregullohen aq përmes një sistemi “sanksionesh” sa përmes vlerësimit përfundimtar prej gjykatësve të provave të paraqitura nga palët, dhe mundësisë që pala kundërshtarë ka për ta kundërshtuar atë; *Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Vendim mbi Mocionin e Millan Llukiqit për shtyrje të dëshmisë për shkak të mospërmbushjes me kohë të detyrimit për nxjerrje materiali, me Shtojcat Konfidenciale A dhe B, 3 nëntor 2008, para. 18, ku Mbrojtjes i lejohej të thërrasë përsëri dëshmitarët e prokurorisë për pyetje të mëtejshme; *Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Vendim në lidhje me moszbatimin prej Prokurorisë të detyrimeve të nxjerrjes së materialeve bazuar në Rregullën 66(A)(ii), 5 nëntor 2008, f. 4-5, ku urdhërohet mospërfshirja e dëshmisë së një dëshmitari dhe heqja e tij prej listës së dëshmitarëve; *Prokurori k. Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5ë18-T, Vendim mbi Mocionin e 49-të dhe 50-të të të Akuzuarit në lidhje me shkelje të detyrimit të nxjerrjes së materialeve, 30 qershor 2011, ku Prokuroria udhëzohet që të paraqesë “shpjegim të hollësishëm në lidhje me mospërmbushjen prej saj të detyrimeve të nxjerrjes së materialeve” dhe të “bindë Dhomen se janë marrë të gjitha masat për të garantuar se zhvillimi i procesit nuk do të ndikohet nga çështjet e vazhdueshme lidhur me mosnxjerrjen e materialeve.” *Shih gjithashtu Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-A, Vendim mbi Mocionin e Millan Llukiqit për masat zhdëmtuese të mundshme lidhur me shkeljet e detyrimeve të nxjerrjes së materialeve të kryera prej Prokurorisë, 12 maj 2011, para. 22, ku Dhoma konkludon se rregulla 115 mund të përdoret si zgjidhje ligjore për çfarëdo padrejtësie që ka pësuar i Akuzuari si rezultat i shkeljeve të Rregullës 68; *Prokurori k. Ndindilyimana dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-00-56-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për shkelje të pretenduara të detyrimit të Prokurorisë sipas Rregullës 69, 22 shtator 2008, para. 64, ku Mbrojtjes i jepet mundësia për t’u bërë pyetje shtesë disa dëshmitarëve të Prokurorisë dhe për të ftuar dëshmitarë të tjerë sipas nevojës.

¹⁰⁵ *Prokurori k. Karemera dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-44-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit RPF dhe për sanksione kundër Prokurorisë, 19 tetor 2006 (“Vendimi Karemera i 19 tetorit 2006”), para. 17, f. 8, ku vendoset sanksion kundër Prokurorisë në përputhje me Rregullën 46(A) “duke i dhënë vërejtje zyrtare Prokurorit personalisht, si organ disiplinor, për këtë sjellje shpërdoruese”;

shërbejnë si mekanizëm i përshtatshëm për garantimin e një procesi të drejtë gjyqësor, Shumica konstaton se në rast të vendosjes së sanksioneve të tilla ndaj një avokati, duhet të zbatohen kriteret e Rregullës 46.

42. Shumica, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Hall, konkludon se z. Rogers mund t'i jepet vërejtje individuale në bazë të Rregullës 46 dhe me garancitë procedurale që mundëson ajo. Për këtë arsye, arsyetimi i Vendimit të Apeluar është qartësisht i gabuar, fakt që përlligj rishikimin dhe shfuqizimin e vërejtjes.

43. Në Mocionin e saj të Rregullës 68, Mbrojtja nuk kërkoi ndëshkimin e z. Rogers bazuar në Rregullën 46 dhe Dhoma nuk është e gatshme të veprojë *proprio motu*.

44. Gjithashtu, në Mocionin e saj të Rregullës 68, Mbrojtja nuk kërkoi ndëshkimin e Prokurorisë në bazë të Rregullës 68bis dhe Dhoma nuk është e gatshme të veprojë *proprio motu*.

V. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura, Shumica, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Hall, **MIRATON** Mocionin dhe

Prokurori k. Ndingilyimana dhe të tjerëve, Lënda Nr. ICTR-00-56-T, Vendim mbi Mocionin e Bizminugut për Masa Zhdëmtuese pas mosnxjerrjes së dokumenteve nga ana e Prokurorisë që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit të prokurorisë AOE, 18 shkurt 2009, para. 9, f. 4, ku Dhoma dha vërejtje në përputhje me Rregullën 46(A) si masë kundër mosrespektimit të Rregullës 68 prej Prokurorisë dhe veprimeve që “penguan zhvillimin e duhur të procesit”; *Prokurori k. Karemera dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-44-T, Vendim mbi Kërkesën e Rregullës 68(D) paraqitur prej Prokurorisë dhe Njoftimin e dymbëdhjetë të Joseph Nzirorera për shkelje të Rregullës 68, 26 mars 2009, para. 27, f. 11, ku i jepet vërejtja Kryeavokatit për Hetime të Posaçme të Prokurorisë, në përputhje me Rregullën 46; *Prokurori k. Ntawukulilyayo*, Lënda Nr. ICTR-05-82-T, Vendim gojor për paralajmërim të Prokurorisë, 6 maj 2009, ku Prokurorisë i jepet gojarisht vërejtje, në përputhje me Rregullën 46(A). Dhoma vëren se Rregullorja e Procedurës dhe Provave të TPNR-së nuk përmban një dispozitë të ngjashme me Rregullën 68bis të Rregullores së TPNJ-së dhe për këtë arsye, gjykatësit e TPNR-së mund të vendosin sanksione ndaj Prokurorisë për shkelje të detyrimeve të nxjerrjes së materialeve të Rregullës 68 vetëm mbi bazën e Rregullës 46.

- (i) **SHFUQIZON** vërejtjen dhënë z. Paul Rogers në Vendimin e Apeluar të datës 12 tetor 2011;
- (ii) Në përputhje me Nenin 20(1) të Statutit dhe Rregullën 68 të Rregullores, **URDHËRON** Prokurorin që përmes masave të përshtatshme të mundësojë korrigjimin e interpretimit të gabuar të Rregullës 68 prej Prokurorisë në rigjykimin *Haradinaj dhe të tjerët* dhe parandalimin e çdo padrejtësie tjetër ndaj Mbrojtjes që mund të lindë nga praktika e nxjerrjes së materialeve.

Gjykatësi Hall bashkëlidh mendimin e tij pjesërisht mospajtues.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 27 mars 2012.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

I. MENDIM PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT HALL

1. Megjithëse jam me shumicën përse i përket shfuqizimit të vërejtjes sepse termi i përdorur në Vendimin e Apeluar “vërejtje”, mund të ketë pasur efektin e masës sipas Rregullës 46 kundër z. Rogers pa i akorduar garancitë e kësaj rregulle, gjithsesi duke u bazuar në vlerësimin tim mbi synimin e Rregullës 68bis, unë shpreh me respekt mospajtimin me konkluzionin e kolegëve të mi se në Vendimin e Apeluar “arsyetimi ishte qartësisht i gabuar”

1

2. Në bazë të Rregullës 46, “pas...paralajmërimit të duhur” Dhoma mund të penalizojë një avokat duke mos lejuar praninë e tij në gjyq ose duke e raportuar sjelljen e tij në shoqatën profesionale të vendit të tij. Këto janë masa shumë të rënda që përdoren për sjelljet më shkelëse. Sipas meje, nëse marrin parasysh gjithë Rregulloren, nuk mund të arrijmë logjikisht në përfundimin se Rregulla 46 ofron të vetmin opsion për ndëshkimin e sjelljes kundërvajtëse të një avokati të Prokurorisë.

3. Rregulla 68bis përcakton se “Gjykatësi paragjyqësor ose Dhoma Gjyqësore mund të vendosë *proprio motu* ose me kërkesë të cilësdo palë, në lidhje me sanksionet ndaj palës që nuk i përmbush detyrimet për nxjerrje materiali në bazë të Rregullores” dhe kjo rregull nuk është pa garanci. Nëse një dhomë gjyqësore do të ishte e gatshme të ushtronte kompetencën e saj *proprio motu*, në bazë të rregullave të drejtësisë natyrale, pala në fjalë do të ftohej të argumentonte pse nuk duhej marrë masë. Në çështjen aktuale, Mbrojtja kërkoi vërejtje kundër z. Rogers i cili paraqiti përgjigje me shkrim dhe me gojë se jo vetëm që nuk ekzistonin arsye për vërejtje kundër tij, por para së gjithash nuk kishte shkelje të Rregullës 68 me përjashtim vetëm të një materiali.² Me fjalë të tjera, mendimi i z. Rogers u dëgjua dhe ai kishte mundësi të shumta për t’u mbrojtur.

¹ Shih Prokurori k. Stanislav Galiqit, Lënda Nr. IT-98-29-A, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikim, 16 korrik 2004 (Vendimi Galiq), f.2

² Vendimi i Apeluar, para 49-51.

4. Vendosja e një “sanksioni” individual (sipas terminologjisë së Rregullës 68bis) në kuadrin e Rregullës 68bis është i përshtatshëm për shkelje të rënda të detyrimit për nxjerrje materiali, por jo aq të rënda sa të shkaktojnë mundësinë e ndëshkimit sipas Rregullës 46. Rregulla 68bis i akordon shprehimisht Dhomës kompetencën e ‘sanksioneve’ për shkelje të detyrimit për nxjerrje materiali. Kompetenca për dhënien e vërejtjes një avokati sipas Rregullës 68bis është opsion i nevojshëm për ballafaqimin e avokatit me përgjegjësinë e shkeljeve të rënda të mosnxjerrjes së materialit dhe për parandalimin e shkeljeve të mëtejshme. Nëse Dhoma do të privohej prej kësaj mundësie, do të cenohej aftësia e saj për administrimin e procesit gjyqësor, trajtimin e sjelljes kundërvajtëse të një avokati dhe garantimin e respektimit të Rregullës 68. Gjithashtu mund të krijohej edhe atmosfera e mosndëshkimit duke u dhënë avokatëve përshtypjen se ata nuk mbajnë përgjegjësi për kundërvajtje, me përjashtim të rasteve kur Dhoma ndërmerr masën e jashtëzakonshme të zbatimit të Rregullës 46. Dhoma e Apelit ka theksuar se detyrimi për nxjerrjen e provave me gjasë shfajësuese është thelbësor për garantimin e gjykimit të drejtë³ dhe se “nuk do të tolerojë asgjë që nuk përputhet përpikmërisht me detyrimet për nxjerrjen e materialit”.⁴ Nuk mund të bëhet interpretim aq i ngushtë i Rregullës 68bis sa të pengojë realizimin e këtij objekti. Faktikisht nëqoftëse çfarëdo veprim që vjen në vëmendje të Dhomës Gjyqësore brenda kornizës së Rregullës 68bis, do të rezultonte në një masë sipas Rregullës 46, atëherë kjo të pasqyrohej nëpërmjet shprehjes “në bazë të Rregullës 46” ose formulimeve të ngjashme.

5. Faksi se në të shkuarën nuk është vendosur asnjë sanksion individual sipas Rregullës 68bis, nuk pamundëson një sanksion të tillë sipas kësaj rregulle. Ndoshta shkeljet e mëparshme të Rregullës 68bis nuk ishin aq të rënda sa të përlligjin sanksion kundër një avokati të Prokurorisë ose ekzistonin masa të tjera zhdëmtuese si moslejimi i përdorimit prej Prokurorisë i materialit të panxjerrë, masë e cila nuk është e disponueshme në këtë rast. Vendimi i Dhomës për sanksion kundër z. Rogers synonte t’u shërbente interesave të drejtësisë dhe të garantonte gjykim të drejtë.

³ *Prokurori k. Kërstiqit*, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykim, 19 prill 2004 (“Aktgjykimi i Apelit Kërstiq”), para 180.

⁴ Po aty, para 215. *Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Vendim Konfidencial mbi Mocionin e Millan Llukiqit për masa zhdëmtuese kundër shkeljeve për nxjerrje materiali prej Prokurorisë, 12 maj 2001 (“Vendimi Llukiq”), para 23.

6. Prokuroria nuk ka provuar se rishikimi është i nevojshëm për zhdëmtimin, qoftë prej “arsyetimit qartësisht të gabuar”, apo prej një “padrejtësie” shkaktuar nga vendimi i parë i Dhomës.⁵ Për mendimin tim, sanksionet individuale të Rregullës 68*bis* nuk synojnë dhe nuk duhet të ndikojnë në aftësinë e kryerjes së detyrës profesionale të z. Rogers në Tribunal.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Burton Hall

⁵ *Shih Vendimi Galiq, f. 2.*